



## **SYLLABUS I LËNDËS “EKONOMIKS”**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Ekonomiks</b>
<b>Programi:</b>	<b>Agrobiznes</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bsc</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative(O)</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>7</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Semestri I</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. asoc. dr. Ekrem Gjokaj</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:ekrem.gjokaj@uni-prizren.com">ekrem.gjokaj@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Nga kjo lëndë studentët do të fitojë njohuri të përgjithshme të performancës ekonomike dhe të biznesit. Ekonomiksi ka të bëjë me studimin se si alokohen burimet e kufizuara në njërën anë dhe dëshirat e pakufizuara të një shoqërie në anën tjetër. Studimi i ekonomiksit do t'u mundësojë studentëve të bëjnë një vlerësim më të mirë dhe do të jenë në gjendje të kontribuojnë në diskutimet mbi kontekstin politik, ekonomik dhe shoqëror. Planprogrami i Ekonomiksit i njofton studentët me konceptet dhe parimet përkatëse ekonomike që do të sigurojnë bazat e nevojshme për një kuptim të duhur të mënyrës se si funksionojnë ekonomitë, veçanërisht ekonomitë e shteteve të vogla si ajo e Kosovës. Kjo lëndë gjithashtu u jep studentëve njohuri dhe aftësi kritike për të komunikuar ide duke iu pasuruar fjalorin me shprehje ekonomike, si dhe do të ofron një bazë të dobishme për studime të mëtejshme në ekonominë bujqesore.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi kryesor i kësaj lënde është t'u ofrojë studentëve mundësi për të fituar një kuptim më të mirë të biznesit dhe proceseve ekonomike. Planprogrami synon të zhvillojë tek studentët: një kuptim i koncepteve themelore ekonomike, teorive dhe parimeve, dhe mjeteve dhe metodave të analizës të përdorura nga ekonomistët; aftësia për të përdorur mjetet dhe metodat e arsyetimit ekonomik për të shpjeguar dhe analizuar çështjet ekonomike, dhe për të vlerësuar perspektivat dhe vendimet e udhëheqësve të agrobizneseve; shprehja e të lexuarit në mënyrë kritike, nga një larmi burimesh, do iu mundëson studentëve të marrë informacionet e nevojshme në lidhje me aktivitetet dhe politikatat ekonomike në ndryshim në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare; dhe do t'i aftësojë studentët për të përdorur prova dhe marrjen e argumenteve të arsyeshme ekonomike të cilat do të shpijnë në arritje të vendimeve racionale dhe të konsideruara.</p>
<b>Rezultatet e të nxënës:</b>	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në



	<p>gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptojnë konceptet dhe parimet themelore të përdorura në analizën ekonomike;</li> <li>• Të zhvillojnë aftësitë për të vlerësuar çështjet ekonomike që do të ndikonin në jetën e tyre si punëtorë, konsumatorë dhe qytetarë;</li> <li>• Zhvillimi i kompetencës për të kontribuar në diskutime mbi çështjet aktuale ekonomike dhe vendimet që duhet të merren për të formësuar dhe forcuar institucionet vendore, lokale dhe kombëtare;</li> <li>• Zhvillimi i aftësisë për të analizuar, në mënyrë kritike, vendimet ekonomike të marra nga politikëbërësit;</li> <li>• Demonstrojnë një vetëdije për faktin se ekonomistët mbajnë pikëpamje të ndryshme për disa çështje ekonomike.</li> </ul>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrimeteorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	4	2	8
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet ,etj	1	9	9
<b>Totali</b>			<b>175 orë (7 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mesimdhënie, interaktivitet, Prezantime, Ese/Veshtrim Kritik, Detyrë Kursi, Provim Përfundimtar.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Pjesëmarrja ne Ligjerata: 10%, Prezantimi ne Ligjerata/ interaktiviteti: 10%, Pergaditja dhe prezantimi i eses/veshtrim kritik: 40%, Provimi final: 40%, Total: 100%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Richard Lipsey and Alec Chrystal, 2020, Economics 4<sup>th</sup></li> </ul>		



	<p>Edition, Oxford University</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Andrew Gillespie 2019, Foundations of Economics 5<sup>th</sup> Edition, Oxford University</li> <li>• Sloman J. Garratt D. 2016, Essentials of Economics Pearson 7<sup>th</sup> E, Education Limited Edinburgh Gate Harlow CM20 2JE United Kingdom</li> <li>• James R. Mcguigan, R. Charles Moyer 1993 Managerial Economics 6<sup>th</sup> Edition West Publishing Company</li> </ul>
<b>Literatura shitesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gaspar, Bierman, Kalari, Hise, Smith, Arreola – Risa : Hyrje në Biznes Tiranë, 2007 .</li> <li>• Gani Gjini : Tregtia e Jashtme si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosoves . Prizren, 2005.</li> <li>• Musa Limani : Hyrje në Ekonomi Prishtine, 2002.</li> <li>• Ahmet Maçellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici : Hyrje në ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007.</li> </ul>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Parimet Themelore të Ekonomisë	Shpërndarja e temave të projekteve seminarike.
<i>Java e dytë:</i>	Mikroekonomia - Idetë themelore ekonomike dhe alokimi i burimeve	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës parë të ligjëratave.
<i>Java e tretë:</i>	Ndërhyrja mikroekonomike e qeverisë	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dytë të ligjëratave.
<i>Java e katërt:</i>	Mungesa, zgjedhja dhe kostoja e mundësisë	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tretë të ligjëratave.
<i>Java e pestë:</i>	Faktorët e prodhimit, alokimi i burimeve në sisteme të ndryshme ekonomike dhe çështjet e tranzicionit	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës katërt të ligjëratave.
<i>Java e gjashtë:</i>	Sistemi i çmimeve dhe mikroekonomia	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës pestë të ligjëratave.
<i>Java e shtatë:</i>	Ndërveprimi i kërkesës dhe ofertës, ekuilibri i tregut dhe disekuilibri	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës gjashtë të ligjëratave.
<i>Java e tetë:</i>	II Makroekonomia	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës shtatë të ligjëratave.
<i>Java e nëntë:</i>	Rritja ekonomike, zhvillimi ekonomik dhe qëndrueshmëria	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tetë të ligjëratave.



<i>Java e dhjetë:</i>	Llojet e politikave: politika fiskale, politika monetare dhe politika e furnizimit	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës nëntë të ligjëratave.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Politikat për korrigjimin e disekuilibrit të bilancit të pagesave, politikat për të korrigjuar inflacionin dhe deflacionin	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dhjetë të ligjëratave.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Punësimi / papunësia	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës njëmbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analiza e kërkesës totale (AD) dhe furnizimit agregat (AS)	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dymbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Synimet e politikës makro qeveritare	Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës trembëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve.	Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve.
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjëratat, marrin pjesë në vizita studimore në terren (ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.		